

MARREVESHJE TRANSFERIMI KUOTE

Sot me date 10/09/2022, palet e meposhtme. bien dakord dhe nen shkrunjne kete Marreveshje (me poshte referuar si "Marreveshja"):

1. - Z. Thanas Torra i biri i Selmanit , shtetas Shqiptar, lindur ne Pogradec me 15.03.1964 nr Id G40315155O ("Dhuruesi")
2. .Z. Nexhmi Torra i biri i Selmënit , shtetas Shqiptar, lindur me 18.06.1971, dhe banues ne Pogradec , mbajtes i leternjoftimit H10618029H ketu e me poshte referuat si ("Pranuesi i Dhurimit")

MEQENESE:

(A) Z. Thanas Torra eshte Ortak i vetem i shoqerise "Joklen&co" sh.p.k ("Shoqeria"), nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit me NUIS K84322601F me adrese ne Pogradec Rruga Reshit Çollaku, lagjja nr 2, pallati nr 4/17, nr pasurie 4/17-N7, zona kadastrale nr 8582 , me kapital themeltar prej 2.500.000 Loke i ndare ne 100 pjese nga te cilat Z. Thanas Torra zoteron 100 pjese , qe perfaqeson 100 % te kapitalit te Shoqerise

(B) Dhuruesi deshiron t'jia transferoje Pranuesit te Dhurimit Zotit Nexhmi Torra te gjithen pjesen e tij qe zoteron te barabarte me 100% te saj dhe Pranuesi i Dhurimit pranon nga Dhuruesit pjesen e Shoqerise, perkatesisht

Z. Thanas Torra dhuron 100 % te pjesemarrjes, mbas kesaj pranuesi i dhurimit behet zoteruesi i plote 100 te pjesemrjes, pjeseve dhe kapitalit

SAME SIPER, palet bien dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

Dhuruesi i transferon Pranuesit te Dhurimit 100 % te pjesemarrjes se tij ne shoqerine Joklen&co Shpk, pa asnje shperblim ose vlere.

Neni 2

Transferimi i pjesemarrjes

- a- E drejta e pronesise do te transferohet ne favor te Pranuesit te Dhurimit me nenshkrimin e kesaj Marrveshje dhe Regjistrimit te saj prane QKB.
- b- Pranuesi i Dhurimit, Z. Nexhmi Torra , do te jete Ortaku i ri dhe i vetem i Shoqerise , nga data e nenshkrimit te marreveshjes.
Mbas Dhurimit shoqeria do te kete ortake
1- Nexhmi Torra 100 % pjesemarrje te barabarte me 2.500.000 leke 100 pjese
- c- Dhuruesi do ti dorezoje Pranuesit te Dhurimit te gjitha dokumentat, deklaratat ose certifikatat e nevojshme per permbushjen e transferimit e pjesemarrjes ne favor te Pranuesit te Dhurimit dhe per regjistrimin e ketij trasferimi prane Qendres Kombetare te Biznesit , qe do te vertetohet me ekstraktin perkates te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni3

Deklarata dhe Garanci

- a- Dhuruesi deklaron dhe garanton per sa me poshte vijon:



- Dhuruesi është pronar i Ligjshëm i 100% të kapitalit të Shoqërisë "Joklen&co" sh.p.k sikurse vërtetohet nga ekstrakti i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit , bashkëngjitur kësaj Marrëveshje , dhe se nuk ka ndonjë pretendim , egzistues apo të mundshëm, të ndonjë pale të trete ndaj të drejtës së pronësive mbi kuotat.
 - Dhuruesit nuk janë pale në ndonjë çështje gjyqësore , arbitrazhi apo administrative, rezultati i të ciles mund të çojë këto marrëveshje.
 - Kuotat nuk janë objekt i ndonjë kufizimi, barre apo pengimi në favor të ndonjë pale të trete.
- b- Secila pale deklaron dhe garanton palën tjetër se:
- Kane zotësi të plotë juridike për të nënshkruar dhe përmbushur Marrëveshjen dhe se kushtet e parashikuara në Marrëveshje janë të detyrueshme për të.

Neni 4

Detyrimet, Taksat dhe Tarifat

Të gjitha taksat, tatimet, detyrimet, tarifat dhe shpenzimet të tjera të çfaredollos natyre, si të tanishme apo të ardhshme, të aplikueshme në Republikën e Shqipërisë, që ka shoqëria do të paguhet nga Pranuesi i Dhurimit.

Neni 5


Kushte të Përgjithshme

- a- Marrëveshja do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë
- b- Cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis paleve në lidhje me Marrëveshjen do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- c- Marrëveshja përben marrëveshjen e plotë midis paleve në lidhje me objektin e saj dhe ka epërsi mbi cdo marrëveshje të mëparshme me gojë apo me shkrim, midis paleve . Nuk ka asnjë deklaram, nxitje, premtim,, deklaramitim qellimi apo marrëveshje, me gojë apo me shkrim, midis paleve, të cilat mund të kenë ndonjë efekt apo pasoje mbi Marrëveshjen dhe që nuk është përfshirë në Marrëveshje.
- d- Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve do të behen me shkrim dhe do të konsiderohen të dorëzuara rregullisht nëse i dorëzohen dorazi , me postë të regjistruar, ose postë elektronike ose me faks palet në adresat përkatëse,

Marrëveshja është nënshkruar në 3 (tre) kopje origjinale në Shqipëri me të njëjtën vlerë secila.

Dhuruesi

Thanas Torra



Pranuesi i Dhurimit

Nexhmi Torra

